

AKT THEMELIMI
SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ZANELI GOLD" SHPK.

Sot, në Tiranë, më 04/06/2024 bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "ZANELI GOLD" SHPK.

Unë ortaku i vetëm Flavio Zeneli, i biri i Shkelqimit, i datëlindjes 30/04/1996, lindur në Berat dhe banues në Tiranë në adresën: "Rruga Qelqi, Njesia bashkiake nr 6, Kombinat" Tirane i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Nr. 039119647 dhe me numër personal J60430065G, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

THEMELIMI

Neni 1

Themelohet Shoqëria tregtare "ZANELI GOLD" SHPK, e cila do të nënshkruhet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare "ZANELI GOLD" SHPK do të jetë në adresën: "Rruga Muhamet Gjollesha, godina 71, H3, ap. 18", Tirane

Neni 3

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj Tregtar me objekt:

Punime riparime dhe shitje të bizhuterive të floririt dhe argjendit dhe Import-Export

Neni 5

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes të mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.



KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "ZANELI GOLD" SHPK do të drejtohet nga Administratori i saj z. Flavio Zeneli, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

Neni 10

Shoqëria tregtare "ZANELI GOLD" SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria tregtare "ZANELI GOLD" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakut të Vetëm duke u nënshkruar në të gjitha kopjet.

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"ZANELI GOLD" SHPK

ORTAKU I VETËM

Flavio Zeneli

Flavio Zeneli

[Signature]